



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 2, datë 20.01.2022**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Janar, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:04

Data e mbajtjes së mbledhjes : 20.01.2022

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje Jashtë Rradhe

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve !

Të nderuar Këshilltarë! Të nderuar përfaqësues të bashkisë !

E deklaroj të hapur këtë mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik.

Kjo mbledhje është kërkuar nga Kryetarja e Bashkisë. Siç jeni vënë në dijeni me rrugë elektronike materialet ju janë dërguar aty.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën e këshilltarëve.

**Dorina Milja:** Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent...ok..... Adriana Hatellari ?.....

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Adriana ka një problem me adresën e skype, po më shkruan ndërkohë që është pro rendit të ditës por po ja u shkruan dhe me email.

**Dorina Milja:** .....ok... Jurgen Zaza..... prezent ....etj.....deri te Morena Boja.....

Atëherë Kryetar ke 32 këshilltarë që u dëgjjuan online ke dhe 12 vota me email.

(p.s. *Votoi me email gjatë mbledhjes Morena Boja dhe Adriana Hatellari e cila për arsye teknike nuk votonte dot në chat të skype kështu që janë 31 vota nga këshilltarë online dhe 14 vota me email. Gjithsej 45 vota në mbledhje*)

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit. Atëherë meqë kuorumi është i pranishëm kalojmë në miratimin e rendit të ditës. Sot në rend dite kemi vetëm 1 pikë, e cila është:

1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3,5,7 RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA “MILENIUMI” DHE PALLATI NR.4, RRUGA “MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
---	--

Kemi ndonjë koment përsa i përket rendit të ditës?....

Nuk kemi, atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës? .....(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*)...

Kundra? .....Apstenim?.....

Ju lutem të votojë kush nuk ka votuar ende.

Eneida mund të ma konfirmosh është mbyll procesi i votimit?

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Jo ende, janë duke votuar kolegët. Deri më tani të gjithë kanë votuar pro rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi :** Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë.

**Eneida Marku (asistenca teknike) :** Atëherë kolegët kanë përfunduar procesin e votimit.

**Ani Dyrmishi :** Atëherë faleminderit .

*Me të gjitha votat pro miratohet rendi i ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 1** dhe të vetme të këtij rendi, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

**Alneida Roshi :** Faleminderit Kryetar !

Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon për pikën 1 për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Elio Jani.

**Elio Jani** : Faleminderit Kryetar ! Përshendetje të gjithëve !

Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit!

Komente përsa i përket pikës, ka nga ana e këshilltarëve ?.....

Atëherë nuk ka, kalojmë në votim .

Kush është pro miratimit të pikës 1 dhe të vetme të rendit të ditës? .....*(ndërkohë qetësi... votohet në chat)* .

Kundra? ..... Apstenim?.....

Ju lutem, të votojë kush nuk ka votuar ende.

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Votimi ka përfunduar. Atëherë kolegët kanë votuar pro pikës 1. Vetëm një sekond se kemi dhe një koleg që po voton.

**Ani Dyrmishi**: Atëherë ka më Eni që po votojnë ?

**Eneida Marku (asistenca teknike)** : Jo

**Ani Dyrmishi**: Atëherë votimi ka përfunduar .

*Me të gjitha votat pro miratohet pika 1 dhe e vetme e rendit të ditës.*

Ju faleminderit të gjithëve për pjesmarrjen. Për mbledhjet e ardhshme ose të rradhës do të njoftoheni nga Sekretaria e Këshillit.

Ju falenderoj të gjithëve dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 3(tre) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funksionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.*

**Mbajtësi i proçesverbalit**: Dorina Milja

### **Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI